



SISTEMET E MBESHTETJES SE VENDIMMARRJES

1

DSS (Decision Support Systems)


MENAXHERËT DHE PROCESI I VENDIMMARRJES

- Për të vlerësuar se si janë ndërtuar SI-të për të mbështetur menaxherët, duhet kuptuar së pari se çfarë bëjnë ata. Rolet e menaxherëve mund të kategorizohen në:
 - **Role ndërpersonale:** udhëheqës, figurë qendrore, koordinues.
 - **Role informuese:** kontrolli, shpërndarësi i informacionit, komunikimi.
 - **Role vendimmarrëse:** sipërmarrës, zgjidhës problemeve, shpërndarës i burimeve dhe nogociator.

- **Sistemet e informacionit**, kryesisht mbështesnin rolin informues, edhe këtë pjesërisht, sepse ky është roli më i lehtë për tu mbështetur.
- Por, në këtë moment, **menaxherët** mernin një sasi shumë të madhe të dhënash, ndërsa atyre iu mungonte mbështetja në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve.
- Në vazhdimësi, shumë mjete **IT** lindën dhe janë duke u zhvilluar për të zgjidhur problemet e teknologjive të mëparshme. **SI** kanë ndryshuar për t'ju përgjigjur nevojave të menaxherëve për të mbështetur rolet menaxheriale.

- Në këtë cështje interesi kryesor është në identifikimin e IT që mbështetin rolet vendimmarrëse. Për këtë, puna e menaxherëve ndahet në dy pjesë: *identifikimi i problemeve dhe vendimi*.
- *Vendimmarrja dhe zgjidhja e problemit.*

Vendimi ka të bëjë me zgjedhjen e bërë midis dy ose më shumë alternativave. Dy kategori të gjëra vendimesh janë zgjidhja e problemit dhe eksplorimi i oportuniteteve.



MJETET IT PËR MARRJEN E VENDIMEVE

- Diskutimi mbi mbështetjen e IT për marrjen e vendimeve ka të bëjë me tre pyetje kryesore të trajtuara më poshtë:
- *1. Pse menaxherët kanë nevojë për mbështetje IT*

Vendimet e zgjuara kërkojnë informacion të saktë dhe të vlefshëm. Informacioni nevojitet në secilën fazë të procesit të vendimmarrjes.

2. Marrja e vendimit ndërsa informacioni përpunohet manualisht është shumë e vështirë sepse:

- ka shumë alternativa, skenarë dhe risqe për tu shqyrtuar
- shumë vendime merren nën presion kohor
- duhen ndërmarrë analiza të sofistikuar për shkak të pasigurisë dhe luhatje në mjedisin e marrjes së vendimit
- vendi i menaxherit dhe ai i marrjes së vendimit mund të jetë i ndryshëm
- shpesh kërkohet parashikim i çmimeve, pjesës së tregut etj., gjë që kërkon mjete analitike

NJË SISTEM DSS MUND TË:

- shqyrtojë shumë alternativa shumë shpejt
- mbështesë parashikimin
- sigurojë një analizë risku
- të integrohet me sistemet e komunikimit dhe bazat e të dhënave
- mbështesë punën në grup.

Se si arrihen të gjitha këto do të tregohet më tej në çështjen

3. A MUND TË AUTOMATIZOHET PLOTËSISHT PUNA E NJË MENAXHERI

- Automatizimi i disa detyrave mund të kursejë kohë, të rritë realizimin e tyre dhe të mundësojë vendime më të mira.
- Në përgjithësi është vënë re se puna e një menaxheri të mesëm është më e mundshme për tu automatizuar sepse ata marrin vendime kryesisht rutinë.
- Menaxherët e niveleve më të ulëta nuk shpenzojnë shumë kohë në marrje vendimesh. Në fakt, ata mbikqyrin, motivojnë dhe trainojnë punonjësit.

- Disa nga vendimet e tyre rutinë mund të automatoizohen, por ato që kanë të bëjnë me aspekte të sjelljes, jo.
- Edhe nëse automatizohet plotësisht vendimmarrja e tyre, nuk mund të automotizohet plotësisht puna e tyre.
- Ndërsa puna e menaxherëve të lartë është më pak rutinë nga të gjitha dhe si e tillë, më e vështira për tu automatizuar.

CFARË TEKNOLOGJISH JANË SOT TË VLEFSHME PËR MBËSHTETJEN E MENAXHERËVE ?!

- Disa mjete IT janë përdorur në mënyrë të sukseshme për të mbështetur menaxherët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekt. Web sot mund të lehtësojë gjithashtu këtë mbështetje. Por teknologjia e parë mbështetëse ka qenë DSS, e përdorur që në vitet 1970.
- Këto sisteme sigurojnë mbështetje për vendimet analitike dhe me natyrë sasiore. Së dyti, Sistemet e mbështetjes së Ekzekutivëve (të ndërmarrjes), të ndërtuara fillimisht në vitet 80, kryesisht për mbështetjen e rolit informues.


- Kjo teknologji ishte paraprirësja e BI. Teknologjia e tretë janë GDSS ose DSS në grup, që mbështetin menaxherët dhe stafin që punojnë në grup, larg ose afër njëri-tjetrit.
- Këto teknologji mund të punojnë të ndara apo së bashku, të kombinuara, duke siguruar secila një aftësi të ndryshme. Ato shpesh lidhen me magazinat e të dhënave.
- Teknologjitë e tjera ndihmëse janë PDA - Personal Digital Assistan - telefonat e zgjuar me lidhje Interneti dhe aftësi e-mail dhe komunikim.

PROCESI I MBËSHETJES SË VENDIMEVE NËPËRMJET IT

- Vendimmarrësit kalojnë përmes 4 fazave zakonisht sistematike.
 - Procesi i vendimmarrjes fillon me **fazën Inteligjencës**, ku menaxherët shqyrtojnë situatën, identifikojnë dhe përcaktojnë problemin, të dhënat dhe burimet e tyre.
 - Në **fazën e Dizenjimit**, ata ndërtojnë një model që përfaqëson dhe thjeshton problemin, kjo duke bërë supozime dhe njohur marrëdhëniet midis variablave.
 - Faza e tretë, është **faza e Vleresimit**. Modeli vlerësohet dhe menaxherët vendosin kritere për vlerësimin e zgjidhjeve alternative të cilat identifikohen. Procesi përsëritetet për çdo nënvendim në situata komplekse.

- Faza e katert është **faza e Zgjedhjes** përfshin përzgjedhjen e njërëzve prej zgjidhjeve e cila testohet dhe me pas menaxherët janë gati për zbatimin. Zbatimi i suksesshëm rezulton në zgjidhjen e problemit ose oportunitetit fillestar.
 - Dështimi çon në rikthim në fazat e mëparshme.
- DSS përpiqet të automatizojë disa nga këto faza. Ai është thelbësor në *fazën e Modelimit*.

4 FAZAT DSS



SISTEMET E MBËSHTETJES SË VENDIMEVE

- Një sistem i mbështetjes së vendimeve kombinon modelet dhe të dhënat për të zgjidhur probleme të strukturuar dhe disa probleme gjysmë të strukturuar me përfshirjen intensive të përdoruesit.
- Por termi DSS ashtu sikurse edhe termi MIS apo MSS (Sisteme të Mbështetjes së Menaxherëve) kanë kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm.
- **DSS mund të shihet si një trajtim ose filozofi, më tepër se sa një metodologji e saktë.**

- Shumë kompani po i kthehen përdorimit të DSS për të përmirësuar vendimmarrjen. arsyet e përdorimit të DSS përfshijnë:
 - Nevojën për informacion të freskët, të shpejtë dhe të saktë
 - Reduktimin e vështirësive në raste të shumëllojshmërisë së operacioneve të kompanisë
 - Përballjen me rritjen e konkurrencës së brendshme dhe ndërkombëtare dhe ekonominë e ndryshueshme
 - Problemet me SI ekzistuese
 - Nevoja e përdoruesve për përdorim të lehtë dhe ndërtim të sistemeve nga joprofesionistët

KARAKTERISTIKAT DHE AFTËSITË E DSS

1. Siguron mbështetje për vendimmarrësit e të gjitha niveleve, individë ose grupe, sidomos në situata të strukturuar ose gjysmë të strukturuar duke bashkuar gjykimin njerëzor dhe informacionin objektiv
2. Mbështet vendime të ndryshme të pavarura, ose sekuenciale
3. Mbështet të gjitha fazat e procesit të vendimmarrjes si edhe disa tipe procesesh dhe stilesh.
4. Është i adoptueshëm nga përdoruesi në kohë, për t'iu përgjigjur kushteve të ndryshueshme
5. Është i lehtë për tu ndërtuar dhe përdorur në shumë raste

6. Nxit të mësuarin, gjë që çon në kërkesa të reja dhe përmirësime të sistemit ekzistues, që çon në mësim të mëtejshëm, e kështu me radhë.
7. Përdor zakonisht modele sasiore. DSS-të e avancuara përmbajnë edhe komponenten e menaxhimit të njohurive, që lejon zgjidhjen e problemeve shumë komplekse
8. DSS mund të shpërndalet për përdorim nëpërmjet Web
9. Lejon ekzekutimin e lehtë të analizës së ndjeshmërisë.


STRUKTURA DHE KOMPONENTËT E DSS

- Komponentët bazë të një DSS janë: baza e të dhënave, baza e modeleve, ndërfaqësi i përdoruesit dhe përdoruesit. Baza e njohurive është një komponent shtesë.
- **Baza e të dhënave** përmban të dhëna nga burime të shumta. Disa DSS nuk përmbajnë një bazë të dhënash të ndarë, por të dhënat futen në modelin e DSS sipas nevojës (menjëherë sic mblidhen nga sensorët, apo pajisjet e futjes së të dhënave).
- **Baza e modeleve** përmban modelet e përfunduara dhe tërësinë e rregullave të cilët janë ndërtuesit e nevojshëm për zhvillimin e aplikimeve DSS. Tipet e modeleve përfshijnë modelet financiare, statistikore, matematikore ose ekonomike..

- **Ndërfaqësi i përdoruesit** mbulon gjithë aspektet e komunikimit midis përdoruesit dhe DSS. Një ndërfaqës i ndërtuar mirë mund të përmirësojë produktivitetin e përdorimit të sistemit.
- **Përdoruesit janë vendimmarrësit.** Ata konsiderohen pjesë e DSS shumë interaktive. DSS kanë dy grupe të mëdhenj përdoruesish: Vendimmarrësit dhe specialistet si analistët financiarë, kërkuesit marketing apo planifikuesit e prodhimit).

- **Baza e njohurive** është komponent i DSS më i zhvilluar (avancuar). Ajo është bërë pjesë sepse shumë probleme gjysmë të strukturuar kërkojnë njohuri dhe ekspertizë.
- Baza e njohurive siguron ekspertizën për të zgjidhur pjesë të problemit.
 - P.sh., një bazë njohurish mund të përdoret për vlerësimin e kostos së prodhimit të një ndërtese masive, duke u bazuar në materialet, punën, vonesat dhe faktorë të tjerë, që kërkojnë analizë komplekse, të dhëna dhe gjykim.

Fig 4. komponentet e DSS



SHEMBULL I DSS

- Aplikacionet DSS janë sistemet dhe nënsistemet që i ndihmojnë njerëzve të marrin vendime bazuar në të dhënat që zgjedhura nga një gamë të gjerë të burimeve.
- Për shembull:
 - një nënshtetas (autor) dëshiron të fillojë shitjen e produkteve (librave) on-line ndërkombëtarisht, por së pari duhet të përcaktohet nëse kjo do të jetë një vendim i mençur i biznesit.

- Shitësi mund të përdor një DSS për të mbledhur informacione nga burimet e veta (duke përdorur një mjet si OLAP-Online Analytical Processing), për të përcaktuar nëse kompania ka aftësinë apo mundësi për të zgjeruar biznesin e tij edhe nga burimet e jashtme, të tilla si të dhënat e industrisë, për të përcaktuar nëse është e nevojshme që të përmbushet ndonjë kërkesë.
- DSS do të mbledhë dhe analizojë të dhënat dhe pastaj të paraqesë atë në një mënyrë që të mund të interpretohet nga njerëzit.
- Disa sisteme të vendimmarrjes veprojnë ngjajshëm si agjentët e Inteligjencës Artificiale.

APLIKACIONET DSS

- Aplikacionet e DSS nuk janë burime të vetme të informacionit, si një bazë të dhënash ose një program që grafikisht përfaqëson shifrat e shitjes, por ai është **kombinim i burimeve të integruara të cilat punojnë së bashku.**

